

AKT THEMELIMI
i Shoqërisë "HEM CONSTRUCTION" Sh.p.k.

Sot, më datë 30 / 01 /2023,

- **Z. Emiljan Mango**, shtetas shqiptar, lindur më 18/01/1989, në Përmet, mbajtës i Letërnjoftimit me nr. personal I90118075P, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;
- **Z. Klarent Hadaj** shtetas shqiptar, lindur më 09/07/1988, në Këlcyrë, mbajtës i Letërnjoftimit me nr. personal I80709043T, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;
- **Z. Eduart Kuka**, shtetas shqiptar, lindur më 22/10/1990, në Diber, mbajtës i Letërnjoftimit me nr. personal J01022051D, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

Në përputhje me Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar) dhe Ligjit Nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kanë vendosur të themelojnë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "**HEM CONSTRUCTION" Sh.p.k.** (më poshtë referuar si "Shoqëria").

NENI 1

EMËRTIMI

Emri i Shoqërisë është "**HEM CONSTRUCTION" Sh.p.k.**

NENI 2

SELIA

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga Ndre Mjeda,, Pallati STAR Construction, Seksioni B, Shkalla 1, Njesia Kati Pare, Tiranë.

Shoqëria mund të çelë degë dhe/ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë, si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjeter.

NENI 3

KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përvçe zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asamblesë së Ortakëve.

NENI 4

OBJEKTI

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë:

- Investim, zbatim, zhvillim, projektim, menaxhim i zonave civile, sociale, turistike, industriale, ura, tunele, vepra arti, komplekse të tregtimit dhe të shërbimit bar-restaurant-hoteleri, sinjalistikë etj., si edhe shërbimeve të tjera të veprimtarive tregtare të ngjashme ose të lidhura me to.
- Kryerja e veprimtarive tregtare në fushën e ndërtimit, për prodhim dhe shitblerje të materialeve të ndërtimit.
- Pjesëmarje në projekte ndërtimore, si sipërmarrres, investitor.
- Konsulencë për punim, ndërtim, montim të objekteve civile, veprave inxhinierike dhe menaxhim të investimeve.

- Prodhim dhe tregëtim me shumicë dhe pakicë i materialeve të ndërtimit, import eksport i tyre brenda dhe jashtë vendit, për llogari të vetë shoqërisë si dhe të tretëve, ku përfshihen inerte, gurë, gurë dekorative, gëlqere, pllaka parafabrikate, llaç, çimento, rërë dhe çdo material tjeter për ndërtim.
- Impiante të prodhimit të materialeve të ndërtimit.
- Zhvillim dhe ndërmjetësim i projekteve për rikonstrukzionin e ndërmarrjeve industriale.
- Blerje-Shitje të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme (prona të ndryshme, si troje, toka bujqësore, apartamente banimi, ambjente shërbimi dhe tregimi etj., pasuri këto në pronësi të shoqërisë ose në pronësi të shoqërive të tjera, personave fizike apo juridike, të cilët e autorizojnë për përfaqësim shoqërinë, për blerje-shitje.

Shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha operacionet tregtare, mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, operacione financiare, industriale, që do të vlerësohen të nevojshme apo të dobishme për realizimin e objektit të shoqërisë si dhe të blejë pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërive të tjera që kanë objekt të njëjtë, të ngjashëm apo që lidhet me të vetin. Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.

NENI 5

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributi në të holla i Ortakëve themelues në vlerën 100.000 Lekë (njëqind mijë lekë) dhe është i përbërë nga tre kuota.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **Z. Emiljan Mango**, zotëron 1 kuotë, me 34% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 34.000 Lekë (tridhjetë e katër mijë lekë) të kapitalit themeltar.
- **Z. Klarent Hadaj**, zotëron 1 kuotë, me 33% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 33.000 Lekë (tridhjetë e tre mijë lekë) të kapitalit themeltar.
- **Z. Eduart Kuka**, zotëron 1 kuotë, me 33% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 33,000 Lekë (tridhjetë e tre mijë lekë) të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statutit.

NENI 6

ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori/ët. Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. **Z. Eduart Kuka**, shtetas shqiptar, lindur më 22/10/1990, në Diber, mbajtës i Leternjoftimit me nr. personal J01022051D madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, zgjidhet si Administrator për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

NENI 7

LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 8


DISPOZITA FINALE

Ky Akt Themelimi hartohet në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Përbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortakët themelues të shoqërisë, duke autorizuar **Administratorin Z. Eduart Kuka** për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

ORTAKËT THEMELUES

Emiljan MANGO



Klarent HADAJ



Eduart KUKA

